



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:185147
Datë: 09.12.2023
Numri i dokumentit: 05040093

P.nr.725/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas gjyqtarit të vetëm gjykues Veton Ademaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kaltrina Rexhepi – Imami, në çështjen penale kundër të pandehurit H.J. nga P., rr. ” ” nr. , për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së , i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1037/23, të dt. 28.08.2023, jashtë seancës, me datë 09.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim me numër reference Nd.nr.2102/23 e datës 01.12.2023, e lidhur në mes të pandehurit H.J. nga P., rr. ”...” nr., dhe palës së dëmtuar KEDS me seli në Pejë, të cilën e përfaqëson G. G. nga P.

II.HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1037/23, e datës 28.08.2023.

III. PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit H.J. nga P., rr. ”.....” nr..., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

IV. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të buxhetit të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.1037/23, të datës 28.08.2023, kundër të pandehurit H.J. nga P, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. të KPRK-së.

Lënda pas pranimit në Zyrën e pranimit të gjykatës , është dërguar drejtpërdrejtë në Qendrën e Ndërmjetësimit në Pejë.

Qendra e Ndërmjetësimit në Pejë me datë 01.12.2023 e ka njoftuar gjykatën se i pandehuri dhe pala e dëmtuar janë pajtuar dhe kanë arritur marrëveshje të ndërmjetësimit me numër reference Nd.nr.2102/23 me datë 01.12.2023.

Gjykata pas vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, gjeti se palët kanë lidhur marrëveshjen e ndërmjetësimit me vullnet të lirë dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-009 Për Ndërmjetësim, përkatësisht nenet 12 dhe 15 paragrafi 1, andaj të njëjtën e aprovoi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi si në pikën II dhe III të dispozitivit , përkatësisht hodhi aktakuzën dhe pushoi procedurën penale ndaj të pandehurit, duke u bazuar në nenin 229 paragrafi 5 dhe nenin 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 453 par.1, të KPPRK-së.

Nga të lartë cekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 725/23 me datë 09.12.2023

Gj y q t a r i
Veton Ademaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.